



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA HANI I ELEZIT

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

DAT: 20.02.2023

Vendi: Hani i Elezit, objekti i shtëpisë Kulturës

Ora :14:00



RAPORT LIDHUR ME DEBATIN PUBLIK

Procesverbal lidhur me diksutimin publik per Planin Komunal per Menaxhimin e Mbeturinave
2023-2027

Debati publik fillo në ora 14:00 , ku drejtori i sherbimeve publike z.Arsim Dernjani përshëndeti të pranishmit me fjalë hyrse duke ju faleminderuar të gjithë për pjesmarrje .Në debat publik ishin të pranishëm anëtarët e organizatës CEDE , anëtarët e Eko Klub (nxësit e shkollës mesme), drejtorët e drejtorive komunale : drejtoresha e Administratës Znj Natyra Kalisi, Lindita Bballazhi DF, Isni Luri DKA, Majlinda Kaloshi DZHE, dhe zyrtarë komunal.

Gjatë prezantimit udhëheqi z.Tahir Krasniqi anëtar i organizatës CEDE cili prezantoi në pika të shkurta përmabjatjen e planit si dhe objektivat e planit 2023-2027. Gjatë diskutimit pati pyetje përgjigje nga të pranishmit ku njëra nder pyetje ishin edhe nga zyrtari i Urbanizimit z,Durim Deranjani i cili pyeti për objektivën nr 1 dhe 2 ku parashihet parandalimi dhe minimizimi i mbeturinave si dhe ripordorimi, riciklimi ku morri pergjigje nga ekipi CEDE, gjithashtu me pyetje vazhdoi edhe drejtoresha e zhvillimit ekonomik znj Majlinda Kaloshi e cila pyeti per riciklimin e letres , plastikes , metalit dhe qelqit ku gjithashtu morri pergjigje poashtu nga ekipi CEDE,me pyetje vazhduan edhe nga zyrtaret tjer me pyetje të ndryshme ku njëra ndër të pyetjet ishte për vendin e deponimit te mbeturinave të nguarra ku u pergjigj z.Kujtim Dernjani që një gjë e tillë është sfiduese për komunën e Hanit të Elezit e cila është në vazhdimësi të hulumitimit për ndarjen e një parcele per deponimin e mbeturinave nga ndertimi dhe demolimi, gjithashtu me pyetje vazhdoi edhe drejtoresha e admisnitratës znj.Natyra kalisi ku pyeti anëtarët e organizatës CEDE në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve me theks të veqant për faturimin pasi që kërkohet në indikatorët e performancës ku këtë përgjigje e morri nga z.Tahir Krasniqi pasi që u përgjig se për të ndodhur një gjë e tillë ,komuna duhet të merr për sipër inkasimin. Mbledhja filloi në ora 14:00 dhe mbaroi në ora 15:30 në objektin e shtëpisë Kulturës.

Me respekt,

Drejtori i DSHPE

Arsim Dernjani

